

ALBULENA PLLANA BREZNICA

ROLI I KULTURËS NË MËSIMIN E GJUHËS SË HUAJ

Hyrje

Ka disa përkufizime të ndryshme përsa i përket termit të gjuhës në lidhje me kulturën, kryesisht nga gjuhëtarët e ndryshëm në botë. Do të hedhim vështrimin tek përkufizimi i këtyre dy koncepteve. Në fjalorin e gjuhës angleze Collins¹, fjala **gjuhë** përkufizohet: “**1** a sistem of spoken sounds or conventional symbols for communicating thought. **2** the language of a particular nation or people. **3** the ability to use words to communicate. **4** any another means of communicating: body language. **5** the specialized vocabulary used by a particular group: legal language. **6** a particular style of verbal expression: rough language. **7 Computers** See **programming language**. [Latin lingua tongue]”, ndërsa fjala **kulturë** gjithashtu në fjalorin Collins ka këtë përkufizim: “**1** the ideas, customs, and art of a particular society. **2** a particular civilization at a particular period. **3** a developed understanding of the arts. **4** development or improvement by special attention or training; physical culture. **5** the cultivation and rearing of plants or animals. **6** a growth of bacteria for study”². Po t’i referohemi Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe (Prishtinë, 1981)³, fjala **gjuhë** përkufizohet: “Sistem i veçantë tingujsh, fjalësh, trajtash e rregullash për formimin e fjalëve dhe për lidhjen e tyre në fjali, i cili është mjeti kryesor e më i rëndësishëm që u shërben njerëzve për të mbrojtur e për të shprehur mendimet dhe për t’u marrë vesh njëri me tjetrin në shoqëri”, ndërsa fjala **kulturë** “tërësia e arritjeve të një populli dhe të gjithë njerëzimit në fushën e prodhimit dhe në zhvillimin shoqëror e mendor; shkalla e këtyre arritjeve dhe e këtij zhvillimi në një etapë të caktuar; fusha e zhvillimit shoqëror që përfshin krijimtarinë e gjithanshme në gjuhë, në art, në letërsi, në shkencë, dhe në tërë jetën shpirtërore”⁴.

Ekzistojnë shumë argumente teorike dhe praktike për debatet rreth konceptit të kulturës. Pjesa e jashtme e kulturës është ajo që shihet, dhe paraqet sjelljen e disa besimeve, artit, muzikës, gjuhën. Pjesa e brendshme ose pjesa nën ndërgjegjes është nën sipërfaqen e një shoqërie dhe përfshin besimet, vlerat dhe modelet që janë formuar gjatë historisë së saj dhe që formësojnë modelet e sjelljes. Ne nuk mund të vlerësojmë një kulturë të re vetëm në bazë të asaj që ne e shohim kur takohemi për herë të parë me të. Është shumë e nevojshme të kalohet një kohë relativisht e gjatë me individë që i përkasin një kulture të caktuar. Vetëm kështu

¹ Collins (2000), *New English Dictionary*, Glasgow, f. 422.

² Po aty f.181.

³ *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1981, f. 626.

⁴ Po aty, f. 909.

ne mund të zbulojmë vlerat dhe besime të caktuara, që paraqesin sjelljet themelore një shoqëri.

Përmes globalizimit të përforcuar, në tokën tonë, njohja e gjuhëve të huaja sot është e nevojshme, sesa për çdo gjeneratë më parë. Gjuhët mësohen më së miri në moshë të re.

Të rinjtë duhet të dëshmojnë më shumë njohuri gjuhësore se sa gjeneratat më parë. Krahas gjuhës amtare anglishtja është bërë gjuhë botërore në ekonomi dhe në shkencë. Edhe në rrafshin diplomatik frëngjishtja gjithnjë e më shumë po e dëbohet nga anglishtja. Të rinjtë duhet të zotërojnë sot së paku një gjuhë të tretë që i përgjigjet profilit të profesionit të tyre.

Hapësira ekonomike evropiane në krahasim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës e ka disfavorin e gjuhëve të ndryshme. Edhe pse edhe në Evropë anglishtja po depërton si gjuhë ekonomike dhe shkencore. Edhe në internet dominon gjuha angleze. Përmes rritjes së shpejtë të ofertave lokale po rriten edhe gjuhët lokale.

Në të gjitha vendet evropiane, në shekullin XXI, pluralizmi kulturor dhe diversiteti janë duke u bërë gjithnjë e më shumë, realitet i përditshëm. Për të siguruar funksionimin harmonik të njerëzve dhe grupeve të kulturave të ndryshme dhe karakteristikave fetare, vlerësimi i diversitetit kulturor, tolerancës, dialogut dhe bashkëpunimi bëhen veti themelore të cilat çdo qytetar evropian duhet t'i posedojë. Të mësuarit ndërkulturor, dialogu ndërkulturor, kompetenca ndërkulturore duhet të kuptohet si parakusht për çdo individ për të përballuar sfidat e reja të shoqërive të cilat duhet të bazohen në respektin për njerëzit dhe popujt në diversitetin e tyre.

Të mësuarit e përjetshëm është për shoqërinë e diturisë formula e suksesit të secili individ, nga kjo përfiton edhe sektori i librit. Të mësuarit dhe arsimit edhe në vitet e ardhme do të zhvillohet në letër të shtypur dhe përmes ndërmjetësimit personal të një mësuesi, docenti apo profesori. E-learning mbetet një skutë, edhe pse në forcim e sipër.

Barrierat gjuhësore lidhur me komunikimin e dobët

Çështja është e kuptueshme. Ne të gjithë e kuptojmë njëri-tjetrin nëse jemi folës të së njëjtës gjuhë dhe të të njëjtut nivel, nëse jo, krijojmë barriera pafund të foluri dhe komunikimi. Diferencat gjuhësore dhe kulturore, diferenca në fjalë e në mendime, e bëjnë frazën të pakuptueshme. Një grua me një burrë shpesh kanë diferenca komunikimi edhe brenda së njëjtës gjuhë, kur përfaqësojnë dialekte të ndryshme dhe jo më komunikimi mes gjuhëve të ndryshme.

Familjet me prindër të ndryshëm kanë probleme komunikimi të cilat vijnë nga diferenca gjuhësore dhe nga stilet e ndryshme të komunikimit dhe të jetesës.

Me gjithë diferenca dhe barrierat e krijuara në pikëpamje të komunikimit, njerëzimi me potencialin e pafund human ka rrëzuar të gjitha barrierat ndërkombëtare të luftërave të ftohta,

të udhëtimit, të komunikimit dhe përtej tyre.

Barrierat gjuhësore janë një shprehje simbolike për të treguar vështirësitë që kanë njerëzit për të komunikuar në kohë dhe vende të ndryshme me njëri-tjetrin.

Roli i kulturës në mësimin e gjuhës së huaj

Kontinenti ynë multilingual, Evropa, brenda vetes së saj dhe emigracionit ndërkontinental ka pasur probleme të mëdha në lidhje me mësimin e gjuhëve. Por Evropa si një bashkësi multilinguale ka probleme të komunikimit, pasi çdo komb ka gjuhën e vet. Por nuk ka një gjuhë të përbashkët.

Kultura si element qenësor për mësimin e një gjuhe të huaj

Shprehinë dhe njohuritë që duhet të zotërojnë një i interesuar kompetent, me një kulturë të veçantë, për mësimin e një gjuhe të huaj janë:

- Identifikimi automatik nga ana vizuale i shkronjave dhe fjalëve; njohuritë fonologjike;
- Njohuri të strukturës së gjuhës që mundësojnë të lexuarit, sintaksa dhe morfologjia;
- Njohuri mbi fjalorin;
- Njohuri përmbajtësore dhe mjedisin;
- Përmbledhje e informacionit të teksteve dhe vlerësimi i burimeve të tjera të informacionit;
- Shkëmbim njohurish rreth procesit të të menduarit dhe aftësive për të përshtatur strategji të përshtatshme për arritjen e qëllimit;
- Aftësitë dhe shprehinë fonologjike;
- Motivimin;
- Vetëbesimin;
- Nënvizimin dhe kontrollin mbi leximin e kuptimshëm me shpejtësinë dhe intonacionin e tij;
- Përdorimin e shqisave që lehtësojnë të lexuarit dhe të shkruarit;
- Modifikimin e të shkruarit përmes përmirësimit të shprehive të të lexuarit;
- Bashkëpunimit dhe punës në grup etj.

Gjuha në rolin e marrëdhënieve shoqërore në çastin e bashkëbisedimit

Prezantimi i folësit, varësisht nga ngritja e tij intelektuale: Folësi mund të kërkojë leje duke përdorur *May: May I have a piece of cake? sidoqoftë* nëse folësi e di se dëgjuesi ndodhet në të njëjtin status shoqëror, apo situata është joformale, ai do të përdori formën *Can* për të kërkuar leje: “*Can I have a piece of cake?*” Por kjo nuk ndodhë vetëm në gjuhën e huaj, në këtë rast, në gjuhën angleze, por edhe në gjuhët e tjera. Këtu mund të marrim përdorimin e gjuhës shqipe për të parë çfarë kuptohet me përdorimin e gjuhës në kontekst shoqëror dhe roli i fjalëve.

Ilo Stefanllari në tekstin “*A Course in English Lexicology*”⁵ thekson se fjalët duke qenë njësi gjuhësore u shërbejnë njerëzve për të komunikuar, prandaj fjala ka një funksion komunikativ. Brenda sistemit gjuhësor, fjala apo leksema ekziston si një sistem dhe njësi në të gjitha format dhe variantet e saj.

Xhevat Lloshi në tekstin “*Stilistika dhe Pragmatika e Gjuhës Shqipe*”⁶ shpjegon se gjuha shërben për të komunikuar. Gjuha i shërben edhe një larmie

⁵ I. Stefanllari (2011). *A Course in English Lexicology*, Sh. B. Geer, p.22-23.

⁶ Xh. Lloshi (2010). *Stilistika dhe pragmatika e gjuhës shqipe*, SHBL (botim i dytë), p. 154.

funksionesh shprehëse e shoqërore. Kur komunikimi kryhet në rrethanat e marrëdhënieve shoqërore formale, zyrtare, publike, ndërthurja e faktorëve gjuhësorë e jashtëgjuhësorë sjell një organizim që dallohet nga ligjërimi gojor.

Ka ndryshime rrënjësore midis përdorimit të gjuhës amtare dhe përpjekjes për të mësuar një gjuhë, për të cilën nuk kemi shumë njohuri. Këto ndryshime shpjegojnë sjelljet e njerëzve në klasat e gjuhës së huaj dhe jashtë saj. Ndryshimi rrënjësor është se njerëzit e përdorin gjuhën e tyre, në rastin tonë gjuhën shqipe jashtë klasës. Ndryshe është ta mësosh gjuhën angleze në Kosovë dhe ndryshe ta mësosh atë në Angli apo Amerikë. Në rastin tonë ajo çka mësohet nuk praktikohet jashtë, ndërsa në rastin e dytë dhe të tretë edhe jashtë klase.

BIBLIOGRAFI

- Collins (2000) *New English Dictionary*, Glasgow.
- I. Stefanllari (2011). *A Course in English Lexicology*, Sh. B. Geer.
- Xh. Lloshi (2010). *Stilistika dhe pragmatika e gjuhës shqipe*, SHBL (botim i dytë).
- V. Biti (2011). *Promoting cultural exchange through teaching foreign languages*, in Proceedings of the International Conference: Building cultural bridges through language literature and translation, may 2011, Tirana.
- J. P. Meunier, Daniel Peraya (2009). *Hyrje në teoritë e komunikimit* (Përkthim nga frëngjishtja), QSSHE, Tiranë.